



Aplikim për vizë me qëllim punësimi në Gjermani

Kjo fletë informacioni **NUK VLEN** si informacion për qëllimet e mëposhtme të aplikimit:

Punësime në fushen e infermieristikës

Kërkim vendi pune

Te kualifikuar te larte / Karta Blu BE

Formim Profesional / Praktikantë

Shërbim vullnetar

Babysitter „Au-Pair“

Ju lutemi lexojeni me kujdes këtë fletë informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni kërkesave të përshkruara aty.

Formular të plotësuar pjesërisht ose dokumentacione të paplota mund të çojnë në kthimin e aplikimit. Një regjistrim i ri për takim ka kohë të gjatë pritje.

Gjatë procesit të aplikimit të vizës ambasada duhet të përfshijë në vendimmarrje edhe autoritetet përkatëse në Gjermani. Procesi si rregull zgjat 2-4 jave, në raste qëndrimesh te mëparshme në Republikën Federale zgjat edhe me shume. Ju lutemi të keni mirësinë që pyetje rreth gjendjes aktuale të aplikimit, nuk mund tu përgjigjemi brenda 5 javëve të para, duke filluar nga momenti i aplikimit.

Në rast se Ju në 24 muaj e fundit përpara aplikimit për vizë keni përfituar pagesa nga ligji i përfitimeve për azilkërkuesit, ne ju këshillojmë të mos aplikoni për vizë.

Për aplikim ju nevojiten dokumentat e mëposhtëm ashtu si janë përshkruar

1.	Formularë aplikimi	Në gjermanisht ose anglisht, 2 copë te plotesuar tërësisht dhe me shkrim të lexueshëm, të nënshkruar nga aplikuesi.
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	Fotografi	3 fotografi identike biometrike , jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhesia 45 X 35 milimeter Ju lutemi te ngjisni dy fotografi në formularët e aplikimit dhe fotografinë e tretë sillini shtesë me vete.
4.	Pasaporta e udhëtimit	Të paktën dy fletë bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i

		<p>vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës.</p> <p>Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale 2 herë.</p> <p>Si rregull pasaporta juaj qëndron gjatë kohës së rregullt të aplikimit 2 deri në 3 javë në sektorin e vizave. Në rast se gjatë kësaj periudhe ju duhet, atëherë lajmëroni në momentin e aplikimit.</p>
5.	Oferta për vend pune ose kontrata e punës	<p>Original dhe dy kopje shtesë</p> <p>Ditën e aplikimit të vizës jo më e vjetër se 6 muaj dhe të përmbajë të dhënat e mëposhtme :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Llojin e punës / Përcaktimin e profesionit • Kohëzgjatjen e punësimit • Pagesën bruto në muaj ose pagesen brutto për orë/pune • Orët e punës në javë

Dokumenta shtesë, të cilat nuk specifikohen këtu mund të kërkohen më vonë, në çdo rast gjatë aplikimit për vizë ose në vijim të procesit nga ana e ambasades.

Ju lutemi vini re, që aplikimi me qëllim punësimi në Gjermani nuk ju jep automatikisht të drejtën ligjore për tu pajisur me vizë.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit në Gjermani, viza ju lëshohet me një kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj. Ju lutemi të udhëtoni në kohën e duhur në Gjermani dhe drejtohuni atje te autoritetet përkatëse, të cilat merren me zgjatjen e lejes së qëndrimit dhe që janë autoritetet përkatëse kompetente për të gjitha çështjet tuaja ligjore si të huaj.

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tij.